



RAPORT

HULUMTIMI I ORGANIZUAR NË KUADËR TË PROJEKTIT Konceptet e qytetarisë të nxënësit të shkollës fillore në Kosovë

1. HYRJJE

Në Kosovë, në dhjetëvjeçarët e fundit, janë bërë ndryshime të shumta në të gjitha fushat e jetës. Njëra prej fushave ku janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen ndryshime të dukshme është arsimi. Në këtë drejtim vëmendje e veçantë i është kushtuar reformimit të sistemit arsimor. Reformat janë bërë me ndihmën e organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, ndërkombëtare dhe vendore. Reformat janë fokusuar në disa rrafshe. Këto rrafshe përfshijnë ndërtimin e shkollave, përgatitjen profesionale të mësimitdhënësve (me anë të trajnimeve të ndryshme), zhvillimin e kurrikulës, përmirësimin e cilësisë në arsim etj. Dinamika e zhvillimit të reformave arsimore lidhet drejtpërdrejt me angazhimin e personave kompetent dhe gatishmërinë e tyre për të kontribuar në këtë aspekt.

Tashmë është e ditur se synimet e shoqërisë kosovare janë për të qenë një shoqëri demokratike. Këto synime mund të realizohen vetëm me ndihmën e kultivimit të vlerave demokratike. Kultivimi i këtyre vlerave është i pamundur pa edukimin qytetar.

Edukimi për Qytetarinë Demokratike (EQD) është me rëndësi të veçantë për avancimin e proceseve demokratike në vendin tonë. Qëllimi kryesor i EQD është përgatitja dhe aftësimi i gjeneratave të reja për të qenë faktor relevantë për të ndihmuar proceset demokratike jo vetëm në bashkësinë ku ata jetojnë por edhe më gjerë.

Edukimi për qytetari demokratike do të thotë të mësosh gjatë gjithë jetës, në të gjitha rrethanat dhe në çdo formë të veprimtarisë njerëzore. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Ministrave Rec (2002) 12 për edukimin për qytetari demokratike, e bën të qartë që të gjitha nivelet dhe linjat e sistemit arsimor duhet të angazhohen në implementimin e EQD në programin mësimor, qoftë si lëndë specifike shkollë, si një lëndë të integruar në kuadër të lëndëve të tjera, apo si temë e programeve tjera. Rekomandimi thekson nevojën për qasje multidisiplinare, për të lehtësuar përvetësimin e dijes, qëndrimeve dhe shkathtësive që kërkohen për tu mundur njerëzve jetë të përbashkët në një shoqëri pluraliste dhe demokratike.

Duke pasur këtë parasysh, është e rëndësishme që të mbahet mend që EQD:

- duhet të jetë në themel të reformave dhe të zbatimit të politikave arsimore;
- është një faktor i rëndësishëm për risitë në fushën e organizimit dhe të menaxhimit të sistemeve arsimore, si dhe të kurrikulës dhe të metodave të mësimitdhënies.

EQD përfshin një numër mjedisesesh të të nxënësve, si në kuadrin e institucioneve shtetërore po ashtu edhe jashtë tyre. Edukimi për qytetari demokratike luan rol esencial në reformat e arsimore që po kryhen në shumë vende të Evropës. EQD konsiderohet si përparësi e politikave arsimore të këtyre vendeve. Këto dhe arsye të tjera ndikojnë që politikat arsimore në Kosovë të fokusohen në edukimin qytetar me një seriozitet më të madh.

Kohëve të fundit, këtu në Kosovë, për qytetarinë po zhvillohen edhe debate të ndryshme, prej nga rezulton fakti se, një nga çështjet me shumë rëndësi, për qytetarët e Kosovës, është edhe ngritja e nivelit të njohjes së koncepteve që lidhen direkt me qytetarinë. Konceptet janë mjete të dobishme për nxënësit. Ato ndihmojnë nxënësit që më lehtë të kuptojnë dhe të mbajnë mend informacionet e reja.

Mund të themi se, në njërin anë, konceptet e qytetarisë përdoren posaçërisht si përpjekje për të stabilizuar dhe modifikuar disa praktika që përfshijnë shkollat tona, dhe në anën tjetër, nëpër mes tyre synohet të arrihet edukimi i përgjithshëm qytetar. Gjithashtu, njohja e koncepteve ndihmon që nxënësit të pranojnë ndryshimet që po ndodhin gjatë viteve të fundit në Kosovë. Edhe pse pjesa më e madhe e studimeve më të reja në fusha të ndryshme sociale, pajtohet me mendimin se shoqëria jonë ka ndryshuar në mënyrë radikale, këtu, ka ende shumë punë për tu bërë. Krahas kësaj, kanë ndryshuar edhe konceptimet teorike të qytetarisë. Këto ndryshime nuk burojnë vetëm nga traditat e ndryshme kulturore dhe sociale, por ato reflektojnë gjithashtu mënyrat e ndryshme të vlerësimit të shoqërisë kosovare dikur dhe sot.

Duhet theksuar që njohja e koncepteve të qytetarisë është e pamundur pa ndërmarrjen e hapave konkret. Kjo nënkupton që shoqëria kosovare duhet të fokusohet për të dhënë kontributin e saj konkret në këtë aspekt. Lidhur me këtë, një kontribut konkret është projekti: “Konceptet e qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë”.

Lidhur me hulumtimet shkencore në terren, mund të themi se, sa i përket fushës së studimeve dhe hulumtimeve në këtë drejtim, tash për tash nuk jemi të kënaqur. Prandaj, projekti hulumtues “Konceptet e qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë”, ka rëndësi të madhe. Ky projekt do të jetë i veçantë dhe do të ndihmojë zhvillimet e proceseve demokratike, jo vetëm në shkollat e Kosovës, por, edhe në shoqërinë kosovare në përgjithësi.

2. PËR PROJEKTIN DHE RËNDËSINË E TIJ

Projekti “Konceptet e qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë”, është realizuar në bashkëpunim nga tri institucioneve, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), Universiteti i Cyrihut (Zvicër) për Edukimin e Mësimdhënësve dhe Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës.

Ky projekt ka filluar në tetor të vitit 2009. Që nga atëherë janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve duke përfshirë edhe një hulumtim. Hulumtimi i bërë në fazën e parë të këtij projekti, tregon që projekte të tilla hulumtimi në Kosovë, janë jo vetëm të nevojshëm por edhe të domosdoshëm. Ky hulumtim do të plotësohet në fazat e ardhshme të zhvillimit të projektit dhe pastaj do të shihen rezultatet tjera konkrete të nxjerra nga ky hulumtim. Këto rezultate do të shërbejnë si fakte-dëshmi për nevojën dhe rëndësinë e këtij projekti.

Qëllimi i hulumtimit në kuadër të këtij projekti ishte që të fitojmë më shumë njohuri për konceptet e ndryshme, fushat e interesit dhe zgjerimi i njohurive në edukimin publik. Pra, ky hulumtim pati për qëllim matjen e njohurive themelore të nxënësve lidhur me konceptet e qytetarisë. Si dhe shpërndarja e idesë se njohja e koncepteve të qytetarisë është e rëndësishme në të gjitha hapësirat demokratike. Të dhënat që do të dalin pas përfundimit të këtij projekti do të ndihmojnë në avancimin e edukimit publik në Kosovë. Bërthama e edukimit për qytetari demokratike janë konceptet e demokracisë dhe të qytetarisë.

Në këtë hulumtim është shfrytëzuar pyetësi nga projekti “INTERNATIONAL CIVIC AND CITIZENSHIP EDUCATION STUDY”, projekt ky i implementuar në shumë shtete. Pyetësi me lejen e autoreve është adaptuar për kushtet dhe rrethanat e Kosovës.

Meqë demokracia është njëra nga konceptet kryesorë dhe ky nocion është i pranishëm në çdo kontekst të edukimit për qytetari demokratike, në pyetësor u është dhënë mjaft hapësirë pyetjeve që kanë të bëjnë me çështje të demokracisë. Në pyetësorët e këtij projekti janë përfshirë të gjitha konceptet themelore që kanë të bëjnë më qytetarinë.

Pyetësorët janë shpërndarë të nxënësit e 4 shkollave. Gjithashtu, pyetësorë të tjerë, të formuluar enkas për mësuesit, u janë dhënë mësuesve për ti plotësuar. Pas përfundimit të punës me pyetësorët, është organizuar një minifokusgrup me nxënësit nga klasat ku është bërë hulumtimi.

Këta pyetësorë janë analizuar dhe pasi që janë mbledhur të dhënat është formuar baza e të dhënave. Të dhënat janë analizuar me anë të programit SPSS.

3. ANALIZA E TË DHËNAVE

Ne do të japim vetëm disa prej të dhënave statistikore që janë rezultat i këtij hulumtimi në shkollat e Kosovës. Për të marrë informacione sa më të shumta për rolin e mësuesit për edukimin qytetar , në pyetësorë janë bërë disa pyetje, psh.: a mund t'i shprehin lirshëm dhe haptas nxënësit mospajtimet e tyre që kanë me mësuesit për çështje të ndryshme politike dhe sociale; a inkurajohen ata që të vendosin vet për çështje të ndryshme; sa u kushtojnë vëmendje mësuesit datave dhe fakteve kur flasin për ngjarje historike apo politike, etj. Gjithashtu, janë bërë pyetje të cilat janë me interes dhe të cilat na ndihmojnë që të njohim nivelin e përgatitjes profesionale të mësuesve.

Në pyetjen: Mësimdhënësit shpjegojnë kurse nxënësit marrin shënime, 56.1% prej nxënësve të anketuar është përgjigjur “shpesh”. 27.2% prej tyre është përgjigjur “nganjëherë”, kurse 14.0% kanë thënë “rrallë”, 0.9% janë përgjigjur me “kurrë” dhe 1.8% kanë thënë se nuk e dinë.

Në pyetjen nëse mësuesit i inkurajojnë nxënësit që të bisedojnë për çështje të ndryshme politike ose sociale, 60% prej nxënësve është përgjigjur pozitivisht. Kurse në pyetjen: Sa herë që diskutohen në klasë çështje të ndryshme, mësuesit i pasqyrojnë këndvështrimet e ndryshme të tyre, nxënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme. (shih. Figura 1).




Figura 1.

Shkolla mbetet vendi kryesor i edukimit për qytetari demokratike. Shkolla është institucion publik që lidhet drejtpërdrejt me interesat e publikut. Shkolla është institucion që ofron njohuri të veçanta. Ajo ofron mundësi për fitimin e aftësive shoqërore, kulturore etj. për jetën në kuadrin e një mjedisi kompleks të të nxënësve.

Shumica e nxënësve, 96.1% prej tyre janë shprehur se shkolla ka qenë faktori kryesor për të kuptuar që njerëzit kanë mendime të ndryshme, 2.3% e nxënësve nuk janë pajtuar me një mendim të tillë. (shih. Figura 2).




Figura 2

Gjithashtu, 97.6% e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse shkolla është vendi ku i ka mësuar ata të punojnë së bashku, 1.5% e tyre nuk pajtohen që në shkollë kanë mësuar për të punuar në grupe, etj.

Zgjidhja e probleme në shoqëri është njëra prej pyetjeve ku 92.1% e tyre janë shprehur pozitivisht. Ata mendojnë që në shkollë kanë mësuar për zgjidhjen e problemeve në shoqëri, kurse 5.4% e tyre kanë dhënë mendimin që në shkollë nuk kanë mësuar për të dhënë kontribut në zgjidhjen e problemeve.

Në pyetjen: Në shkollë unë kam mësuar që të jem qytetar patriot dhe besnik ndaj vendit tim , 84.4% e nxënësve janë shprehur pozitivisht që shkolla ka qenë vendi ku ata kanë mësuar për patriotizmin dhe besimin ndaj vendit, 14% e nxënësve nuk janë pajtuar që në shkollë kanë mësuar për patriotizmin dhe besimin ndaj vendit.

Në një pyetje tjetër: Në shkollë kam mësuar si të veprojmë për mbrojtjen e ambientit, shumica e nxënësve janë shprehur që në shkollë kanë mësuar për mbrojtjen e ambientit meqë 94.6% e tyre janë përgjigjur pozitivisht, 3.9% e nxënësve janë përgjigjur negativisht gjë që nuk kanë mësuar për mbrojtjen e ambientit në shkollë.

Pyetja: Në shkollë kam mësuar se duhet të brengosem edhe për atë se çka ndodh në shtetet e tjera, rezultoi me këto përgjigje. 72.1% e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht që në shkollë kanë mësuar se si të brengosen për atë se çfarë ndodhë në shtetet e tjera, 21.7% e nxënësve janë përgjigjur se nuk kanë mësuar në shkollë se si të brengosen për atë se çfarë ndodhë në shtetet tjera.

Në pyetësorë është shtruar edhe çështja e votimit. 80.6% e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht për që në shkollë kanë mësuar për rëndësinë e votimit në zgjedhje komunale dhe të përgjithshme, 15.5% e nxënësve kanë mohuar që në shkollë kanë mësuar për rëndësinë e votimit për zgjedhjet komunale dhe të përgjithshme.

Shumica e nxënësve 93.1% e tyre janë përgjigjur pozitivisht dhe shohin të dobishme që zgjedhja e përfaqësuesit të grupit do të ndikonte në përmirësimin e cilësisë në shkollë, 2.3% nuk kanë njohuri për këtë pyetje dhe 3.8% e nxënësve nuk e shohin të dobishme zgjedhjen e përfaqësuesit të grupit në përmirësimin e cilësisë në shkollë.

Punën e përbashkët të tyre nxënësit e shohin të dobishme për ndryshimet pozitive në shkollë nga fakti që 96.9% e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje, 1.5% e nxënësve nuk e kanë kuptuar pyetjen dhe 1.5% e tyre nuk shohin të rëndësishme punën e përbashkët për ndryshime pozitive.

Organizimin e grupeve të nxënësve për zgjidhjen e problemeve e shohin të dobishëm nga fakti që 93% prej nxënësve janë përgjigjur pozitivisht, 1.5% e nxënësve nuk e kanë kuptuar pyetjen dhe 5.4% e tyre nuk e shohin organizimin e grupeve të nxënësve si mjet për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.

Sipas mendimit të nxënësve, përkrahja e shokëve të klasës ka rëndësi të madhe. Këtë e dëshmon fakti që 93% e tyre janë përgjigjur pozitivisht lidhur me këtë çështje. Nxënësit i kuptojnë të drejtat e tyre dhe ndjehen të lirë në kërkimin e tyre, 6.1% e tyre janë shprehur negativisht dhe 0.76% nuk e kanë kuptuar pyetjen.

Për zhvillimet e shkollës shumica e nxënësve janë për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Kjo rezultoi nga analiza e pyetësorëve ku 91.4% e nxënësve janë përgjigjur pozitivisht, 3.8% e tyre nuk e kanë kuptuar pyetjen dhe vetëm 4.7% prej tyre e shohin mënyrën individuale më me ndikim në zhvillimet e shkollës.

Nxënësit janë të interesuar për zgjidhjen e problemeve të shkollës. Rezultati i hulumtimit është: 90.7% e tyre janë shprehur pozitivisht, 2.3% nuk e kanë kuptuar pyetjen dhe vetëm 6.9% prej tyre nuk kanë shprehur interesim për problemet e shkollës.

Gjithashtu, shumica e nxënësve shprehin gatishmëri për dhënien e mendimeve për problemet e shkollës nga fakti që 85.2% e tyre janë shprehur pozitivisht, 7% prej tyre nuk e kanë kuptuar pyetjen dhe 7.7% prej tyre nuk treguan gatishmëri në dhënien e mendimeve për problemet e shkollës.

Në pyetjen lidhur me të shprehjen e lirë të mendimit të individit që është një nga elementet kryesore të demokracisë, siç shihet, nxënësit kosovarë kanë mjaft njohuri. Nëse 86.5% të të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, kjo tregon se shprehja e mendimit të lirë është karakteristikë esenciale e demokracisë dhe vlerësohet nga nxënësit.

Kur njerëzit kërkojnë të drejtat e tyre politike dhe sociale, sipas të gjeturave pyetësorëve rezultojnë fakti që nxënësit janë të interesuar për mirëqenien e tyre dhe duhet të jenë aktiv në për të bërë ndryshime në shoqëri. (shih. Figura 3).




Figura 3.

Kur partitë politike e kanë si rregull që të përkrahin femrat për t'u bërë lider politik sipas mendimit të nxënësve është mirë për demokracinë.

Nga përgjigjet e nxënësve të anketuar shihet se ata janë pro fuqizimit të grave në politikë. Ky është një segment mjaft i rëndësishëm për mbarëvajtjen e proceseve demokratike. Të dhënat nga pyetësi janë shpresëdhënëse. Rezultatet janë: 52.4% e nxënësve mendojnë se është shumë mirë për demokracinë, 20.0% mendojnë se është deri diku mirë për demokracinë, 10.3% thonë se është deri diku keq për demokracinë, 12.4% thonë është shumë keq për demokracinë dhe 4.8% e tyre nuk e dinë se a është mirë apo keq për demokracinë. Sigurisht që ky rezultat i hulumtimit tregon që barazia gjinore konsiderohet mirë për demokracinë, sepse sipas Deklaratës për të Drejtat e Njeriut edhe gratë janë qenie të barabarta me meshkujt dhe diskriminimi gjinor është i ndaluar. Gjithashtu, në shoqërinë tona po bëhen përpjekje për fuqizimin e gruas në politikë dhe në pozita vendimmarrëse. Njëri nga parimet e EQD lidhet veçanërisht me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin, pjesëmarrjen dhe përkatesinë dhe respektin për larmishmëri.

Pyetjen kur gjykatat dhe gjykatësit janë të influencuar nga politika, disa nxënës nuk e kanë kuptuar pyetjen.

Sipas opinionit të shumicës së nxënësve është shumë keq për demokracinë nëse gjykatësit dhe gjykatat janë të ndikuara nga politika. Mirëpo, në rastin konkret, nga gjithsej 134 nxënës të anketuar, 20 prej tyre (13.5%), janë përgjigjur që nuk e dinë përgjigjen. Kështu që, neve na shtynë të mendojmë që fjala është për të kuptuarit jo të mjaftueshëm të kornizave konceptuale.

Në pyetjen kur ka ndarje (segregim) në mes të shteti dhe religjionit, konsiderohet mirë apo keq për demokracinë, nxënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Vetëm 7.8% e nxënësve mendojnë se është shumë mirë për demokracinë kurse, 60.3% mendojnë se është shumë keq për demokracinë, etj. Këtu dalin në pah dimensione pak më tjera dhe më të ndryshme të qytetarisë. Kalimi i shoqërisë nga një rregullim shoqëror dhe institucional në një tjetër, kërkon më tepër përkushtim, sidomos i personave përgjegjës për një edukim në këtë aspekt. Çështjet e raporteve shtet-religjion, kërkojnë vëmendje dhe përkushtim më të madh. Nisur nga kjo, nuk është për t'u befasuar nga përgjigjet e nxënësve të cilët segregacionin shtet-religjion e shohin si element shumë të keq për demokracinë. Në këtë segment duhet përqendruar vëmendje më të madhe, sidomos te konceptet themelore.

Pyetja: Kur njerëzit kyçen në parti politike në mënyrë që të influencojnë qeverinë.

Edhe në këtë rast del në pah të kuptuarit jo i mjaftueshëm i kornizave konceptuale. 20.3% e nxënësve nuk e kanë kuptuar pyetjen ngase nuk i kanë të qarta shprehjet "kyqje" dhe "influcencë", si dhe për shkak të mungesës së njohurive të zhvillimit të proceseve politike.

Lidhur me të drejtat e njeriut nxënësit janë më të informuar. Mirëpo, përgjigjet e tyre në pyetjen: Kur njerëzit refuzojnë të zbatojnë një ligj që cenon të drejtat e njeriut, si konsiderohet

për demokracinë?- janë mjaft interesante. Kështu që, duke qenë të interesuar për mirëqenien e të tjerëve dhe duke synuar që nxënësit të shprehin opinionet e tyre në mënyrë më të qartë, duhet kërkuar arsyen e këtyre përgjigjeve. Vetëm 34.2% e nxënësve mendojnë se është shumë mirë për demokracinë, kurse 51.4 % e tyre mendojnë se është shumë keq për demokracinë. Deri diku keq/deri diku mirë, mendojnë 6.8% e tyre, kurse 7.5% nuk e dinë.

Në pyetjen: Kur gazetave u ndalohe të publikojnë artikuj që mund të ofendojnë grupe të ndryshme (grupe etnike, imigrantësh, religjioze, raciale, kombëtare etj.), nxënësit janë ndarë pothuajse në dy taborre të kundërta sepse gjysma e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive dhe gjysma tjetër negative.

Këtu, nëse përgjigjet pozitive të nxënësve janë përafërsisht të barabarta me përgjigjet negative të tyre (shumë keq/mirë për demokracinë), atëherë edhe ky është një sinjal që neve na shtynë që të mendojmë që nxënësit i kuptojnë vlerat demokratike por thellësia e të kuptuarit të tyre është sigurisht sipërfaqësore. Kështu që në raste të tilla kërkohet njohuri shtesë për konceptet bazë. Asociacioni Ndërkombëtar për Vlerësim të Arritjeve në Arsim (IEA), ka konstatuar që: "Nxënësit në shumicën e vendeve i kuptojnë vlerat dhe institucionet demokratike, mirëpo, thellësia e të kuptuarit shpeshherë është sipërfaqësore.

Në pyetjen tjetër: Kur gazetat janë të pavarura nga kontrolli i qeverisë (nga shteti, politika), nxënësit kanë dhënë këto përgjigje. (shih Figura 4)




Figura 4.

Në pyetjen kur njerëzit në mënyrë paqësore protestojnë ndaj një ligji për të cilin ata besojnë se është i padrejtë, nxënësit kanë dhënë përgjigje të ndryshme.

Këto të dhëna nga kjo pyetje mund të përdoren edhe si argumente por edhe si opinione të nxënësve të cilët janë të aftë të ushtrojnë ndikim në shoqëri. Ata i karakterizon edhe të qenit të përgjegjshëm në mënyrën e veprimit të tyre si qytetarë. 78.4% e të anketuarve janë të bindur se duhet reaguari ndaj ligjeve që janë të padrejta. Ky është një rezultat që tregon se parimet e edukimit qytetar janë të njohura për shoqërinë. Një nga parimet e edukimit për qytetari demokratike fuqizon shoqërinë civile përmes punës për t'i bërë qytetarët e saj të mirë informuar për çështjet e shoqërisë dhe për t'i pajisur ata me shprehitë demokratike. Gjithashtu, një nga parimet tjera ka për qëllim përgatitjen e të rinjve dhe të rriturve për të marrë pjesë në shoqërinë demokratike, që do të formojë edhe kulturën demokratike. Qytetarët e çdo shteti kanë të drejtë të dinë se cilat janë të drejtat e tyre sipas ligjit, gjithashtu ata kanë të drejtë të dinë edhe përgjegjësitë e tyre ligjore dhe ndaj shtetit dhe ndaj qytetarëve të tjerë. Edukimi për qytetari demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe të shtetit të së drejtës, është mjet i rëndësishëm në luftë kundër dhunës, ksenofobisë, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës, ndihmon në kohezionin shoqëror, në drejtësinë shoqërore dhe në të mirën e përbashkët, fuqizon shoqërinë civile përmes punës për t'i bërë qytetarët e saj të mirëinformuar për çështjet e shoqërisë dhe për t'i pajisur ata me shprehitë demokratike. Gjithashtu, duhet të jetë i larmishëm, në varësi të konteksteve historike, kombëtare, shoqërore dhe kulturore.

3. PËRFUNDIMI

Hulumtimi që është bërë në kuadër të projektit “Konceptet e qytetarisë të nxënësit të shkollës fillore në Kosovë”, ka qenë vetëm një pilot hulumtim, që është bërë në katër shkolla të qytetit të Prishtinës. Të dhënat e dalja na tregojnë se çështja e koncepteve kyçe të qytetarisë dhe edukimit qytetar në përgjithësi qëndron në një nivel të kënaqshëm. Kjo sigurisht, është rezultat i punës së institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, megjithatë, rolin parësor në këtë proces duhet ta ketë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila mund dhe duhet të ofroj kurrikula të mirëfillta, mësimdhënës të përgatitur, që si rezultat kanë edukimin qytetar të nxënësve të Kosovës.

Edhe pse në bazë të të dhënave të këtij miniprojekti çështja e koncepteve kyçe të qytetarisë dhe edukimit qytetar në përgjithësi qëndron në një nivel të kënaqshëm, në këto përfundime duhet të marrim me shumë rezerve, për dy arsye, e para, këto të dhëna nuk mund të jenë reprezentative për të gjithë nxënësit të Kosovës, ngase hulumtimi është zhvilluar vetëm në qytetin e Prishtinës dhe e dyta, shkollat e përfshira janë të gjitha nga zonat urbane.

Kjo na bën të mendojmë dhe të punojmë, që një hulumtim i tillë të zhvillohet në gjithë territorin e Kosovës. Një hulumtim i tillë, do ta ndihmonte shumë Ministrinë e Arsimit për të bërë ndryshimet e duhura në kurrikulin, ngase ndryshimet duhet të jenë në raport me nevojat që do dalin nga terreni.

Gjithashtu, një hulumtim i tillë do ta ndihmonte Fakultetin e Edukimit, që të zhvillojë dhe orientoj programet e veta kah nevojat e nxënësve të Kosovës.

Autorët:

Petrit Tahiri

(Qendra për Arsim e Kosovës)

dhe

Bahtije Gërbeshi

(Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit)

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 12-13 qershor është mbajtur seminari i shtatë në kuadër të programit të MKLSH-së për 4 grupet e mësimdhënësve të Prishtinës, Gjilanit, Ferizajt dhe Pejës. Në këtë seminar mësimdhënësit u njoftuan për procesin e planifikimit të orës mësimore, si dhe për mënyrat e ndryshme të vlerësimit. Në fund të seminarit, të gjithë pjesëmarrësit që kanë vijuar me sukses të gjitha seancat e trajnimit dhe kanë realizuar orët e monitorimit janë certifikuar për pjesëmarrje.

Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës

■ Realizimi i procesit të decentralizimit në arsim në disa komuna të Kosovës inicioi idenë për realizimin e një projekti për monitorimin e financave komunale të arsimit. Ky projekt filloi të zbatohet në 5 komuna të Kosovës: në Istog, Gjilan, Prishtinë, Gjakovë dhe Vushtri. Zgjedhja e tillë e komunave u bë duke respektuar dinamikën e përfshirjes së komunave në projektin e decentralizimit të financave në arsim. Kështu Istogu dhe Gjilani kishin përvojë në zbatimin e decentralizimit, Prishtina dhe Gjakova u përfshinë në fillim të vitit 2010, ndërsa Vushtrria nuk është përfshirë ende. Një zgjedhje e tillë lejonte mundësinë për të bërë krahasime të ndikimit të procesit të decentralizimit në rritjen e shkallës së transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin e financave komunale të arsimit. Pas realizimit të monitorimit në periudhën shtator 2009 - maj 2010, në qershor u përgatit një fletëpalosje me informatat

nga monitorimi dhe u organizuan 5 tryeza të rrumbullakëta në të cilat u bënë publike dhe u diskutuan rezultatet e monitorimit. Në periudhën 22 -23 qershor u organizuan tryezat në Gjilan, Vushtri, Istog, Gjakovë dhe Prishtinë. Në tryeza morën pjesë dhe kontribuan me diskutimet e tyre zyrtarë të arsimit, drejtorë të shkollave, kryetarë të këshillave të shkollës, mësimdhënës, prindër dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Kërkesë e vazhdueshme e të gjithë përfaqësuesve të komunitetit arsimor ishte nevoja për decentralizim të plotë të financave të arsimit në tërë Kosovën.

Projekti për zhvillimin e institucioneve arsimore

Më 14 qershor MASHT ka nënshkruar me KEC marrëveshjen për realizimin e një komponente të projektit të Bankës Botërore për zhvillimin e institucioneve arsimore. Me financim të Bankës Botërore, gjatë 19 muajve vijues rreth 151 shkolla fillore dhe të mesme të Kosovës do të përfitojnë përkrahje financiare për implementimin e projekteve shkollore të cilat kanë për qëllim rritjen e cilësisë në arsim. Roli i KEC do të jetë ofrimi i ndihmës profesionale shkollave në hartimin e planeve zhvillimore dhe projekt propozimeve të cilat do të mbështeten financiarisht nga Banka Botërore. Po ashtu, shkollat do të aftësohen për të monitoruar implementimin e projekteve të tyre si dhe vlerësimin e impaktit të projekteve në ngritjen e cilësisë në arsim.

KOSOVISION Contest

■ Projekti KOSOVISION CONTEST ka përfunduar me një sukses të madh. Pas kaq shumë muajsh punë nga nxënësit më në fund arritëm edhe ta kurorëzojmë përmbylljen e këtij projekti me një organizim të një ceremonie me rreth 500 të ftuar. Në ceremoni u bë edhe shpallja e

klasave fituese. Këtë vit janë shpallur 22 fitues për realizimin e projekteve shkollore dhe ata janë:

Vendi	Shkolla-Klasa	Projekti
Ferizaj	Jeronim De Rada, V3	Kopsht shkollor
Greme-Ferizaj	Jeta e Re, V1	Kopsht shkollor
Ferizaj	Gjon Serreci, V2	Bibliotekë
Guskë-Gjakovë	Pjetër Muçaj, V	Mbledhja e bimëve mjekuese
Gjakovë	Mustafa Bakija, V2	Njohuri mbi mbrojtjen e ambientit
Gjakovë	Mazllom Këpuska, V1	Dhoma e muzikës
Gjilan	Selami Hallaqi, V	Ekskursion me klasën serbe
Gjilan	Musa Zajmi, V1	Renovimi i klasës
Mitrovica	Abdullah Shabani	Drama Multi-Etnike
Llaushë-Skenderaj	Halit Geci, V1	Dekorim i brendshëm i shkollës
Mitrovica	Bedri Gjina, V3	Bibliotekë
Pejë	Vaso Pashë Shkodrani, V1	Kopsht shkollor
Istog	Bajram Curri, V4	Renovim i parkut
Banjë e Pejë	Trepça, V2	Dhoma ime - Mision Humanitar
Banjë e Pejë	Trepça, V1	Ngjyrosja e rrethojës së shkollës
Llugar	Ganimete Tërbeshi, V	Kopsht shkollor
Prishtinë	Ismail Qemali, V3	Kopsht shkollor
Prishtinë	Mileniumi i trete, V1	Libër me tregime
Krojmir	4 Dëshmorët, V	Renovim i klasës
Samadraxhë	Dituria, V1	Dhomë argëtimi për fëmijët e kopshtit
Brod- Dragash	Zenuni, V	Kopsht shkollor
Llapushnik	Shaban Shabani, V1, V2	Fushë sporti

Foto nga ceremonia e ndarjes së shpërblimeve



Në muajt në vazhdim do të fillojnë përgatitjet për vitin e tretë të projektit KOSOVISION CONTEST.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Komisioni Evropian, janë organizuar këto aktivitete:

Implementimi i projekteve shkollore ka mbaruar. Të gjitha shkollat e synuara kanë bërë zgjedhjen e një projekti të cilin e kanë realizuar në shkollat e tyre. Projektet kanë qenë të ndryshme, varësisht nga nevoja që kanë pasur shkollat ose dëshira e nxënësve për të punuar në një projekt. Të gjitha këto projekte janë monitoruar.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Ekipi i ekspertëve e ka përfunduar hartimin e sintezës së raporteve kombëtare. Po bëhen përgatitjet për punëtorinë rajonale që do të mbahet më 4 korrik. Kjo punëtori do të shërbejë për ta rishikuar sintezën e këtyre raporteve dhe për të nxjerrë disa rekomandime. Punëtorja do të mbahet në Kosovë dhe do të marrin pjesë nga 3 përfaqësues të shteteve partnere në projekt. Përveç kësaj ky rast do të shërbejë edhe për t'i diskutuar aktivitetet e ardhshme të projektit.

Access Microscholarship Program

■ Më 8 qershor u mbajt ceremonia për shpërndarjen e certifikatave për nxënësit e Access Microscholarship Program. Kjo ceremoni u mbajt në Këndin Amerikan ku morën pjesë nxënësit dhe prindërit e tyre. Me këtë rast mysafir nderi ishte Ambasadori Amerikan në Prishtinë, Christopher Dell. Pas shpërndarjes së certifikatave fëmijët së bashku me prindërit dhe mësuesin e tyre Mr. Robert Meszaros vazhduan për një koktej rasti në ambientet e Ambasadës Amerikane. Me këtë edhe përfunduan orët e rregullta të Access për këtë grup.

■ Më 19 qershor u mbajt edhe aktiviteti i fundit social. Me këtë rast nxënësit së bashku me mësuesin e tyre dhe bashkëpunëtoren për gjuhë angleze Amy Schirmer dhe koordinatoren e projekti Jehona Shala shkuan në Paintball. Fëmijët u shprehën se kjo ishte një ditë e veçantë për ta.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

■ Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Pas lansimit të këtij projekti me datën 27 maj 2010, filluan përgatitjet për zhvillimin e aktiviteteve që dalin nga ky projekt. Zyrtarët e këtij projekti kanë marrë pjesë aktive në diskutimet publike të organizuara nga MASHT për Kornizën e Kurrikulit të Kosovës, ngase njëra nga komponentët kryesore të këtij projekti është Zhvillimi i kurrikulit.

Gjithashtu në muajin e ardhshëm do të mbahet një fokus grup dhe një punëtori për këtë qëllim.

Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë

■ Gjatë muajit maj, ekipi nga KEC dhe UP, ka punuar në përgatitjen e një raporti të hulumtimit të shpejtë, me qëllim të

publikimi të tij. Pritet që ky raport të publikohet deri në fund të muajit qershor.

Projekti i përbashkët i historisë së Evropës Juglindore (JHP)

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë muajit maj, janë zhvilluar edhe disa aktivitete që kishin për qëllim përhapjen e idesë së shfrytëzimit të burimeve alternative në mësimdhënien e lëndës së historisë.

Përgatiti: Petrit Tahiri